# Elona Toro (Stavri)

GJYQTARE PRANË GJYKATËS SË APELIT TIRANË

Deklaratat e analizuara:

**15 Deklarata të analizuara**

(nga deklarimi Për Herë të Parë 2003 deri Periodik/Vjetor 2017)

## Ndryshimi i pasurisë nga fillimi i deklarimit deri në vitin 2017




Pasuria bruto është rritur 23 herë.

+ 2,893,531 Lekë Rritja mesatare vjetore e pasurisë.

## Ndryshimi i pasurisë sipas kategorive

Vlera në Lekë













## Të ardhurat familjare të krijuara gjatë periudhës deklaruese

| Të Ardhurat 2004-2017 | Shuma në Lekë | Raporti në % |
|---|---|---|
| Të ardhura nga paga dhe shpërblime nga funksioni | 13,629,774 | 24.72% |
| Të ardhura nga paga e familjarëve | 25,694,283 | 46.60% |
| Të ardhura nga biznesi I bashkëshortit | 3,600,763 | 6.53% |
| Dhurata në Cash | 3,130,420 | 5.68% |
| Të ardhura nga shitja e pasurive të paluajtshme | 5,800,000 | 10.52% |
| Të ardhura të tjera | 3,282,931 | 5.95% |
| Total | 55,138,171 | 100% |

## Kontrolli Aritmetik dhe Logjik

Kontrolli Aritmetik dhe Logjik për 14 vite rezultoi:

1 Me Probleme
13 Pa Probleme

Subjekti Elona Toro (Stavri) gjatë periudhës deklaruese deklaron detyrime financiare ndaj të tretëve në shumat : I. në vitin 2009 shuma 51,000 euro dhe 4,000 usd huamarrje për blerje pasuri e paluajtshme në shumën 135,000 euro, nga te cilat 80,000 euro i ka detyrim të papaguar ndaj shitësit. II. në vitin 2011 vlerë 5,000,000 lekë kredi bankare e përdorur për shlyerje detyrimi firmës për aset të blerë në vitin 2009, dhe III. në vitin 2017 kredi bankare 55,000 euro dhe detyrim ndaj firmës së ndërtimit shumën 37,125 euro (për blerje pasurie të paluajtshme në vlerë 102,125 euro).

Në vitin 2011 Subjekti Elona Toro (Stavri) rezultoi me pasuri të pajustifikuar në shumën -6,401,963 lekë (pa llogaritur në këtë analizë shpenzimet vjetore për konsum), kjo për arsye se këtë vit ka shlyer totalin e detyrimit në vlerë 80,000 euro ndaj firmës së ndërtimit per asetin e blerë në vitin 2009.

Gjatë periudhës deklaruese subjekti deklaron dhurata në cash nga të tretët (babai i bashkëshortit) konkretisht në shumat : I. 10,000 euro në vitin 2011 të cilat kanë shërbyer për blerjen e një aseti vendparkim me vlerë 12,000 euro dhe II. 8,000 euro në vitin 2014, e ardhur si shkëmbim aseti truall me apartament banimi sipërfaqe 85.7 m2 ndodhur në Vlorë i cili i është dhuruar bashkëshortit të deklarueses. Gjithashtu në vitin 2009 subjekti deklaron 5,800,000 lekë të ardhura nga shitja e një pasurie të paluajtshme në bashkëpronësi me të atin, aset ky i padeklaruar më parë.